



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr 6873, Datë 15. 05 . 2026

Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”, dhe përdorim të Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; të shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr.3293/1, datë 13.05.2026 “Për njohje e zbatim”; Kryetari i Bashkisë i paraqet projektvendimin përkatës, Këshillit të Bashkisë;

Për të vendosur :

1. Miratimin e një shtese dhe ndryshimi në PBA-në 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026, konkretisht si më poshtë:

1.1. Në pikën 1/a, të shtohen “Burimet e të ardhurave” në shumën 48,868,492 lekë, respektivisht:

- Për vitin 2026 në shumën 10,000,000 lekë, fond i akorduar nga Buxheti i Shtetit.
- Për vitin 2027 në shumën 14,000,000 lekë, fond i akorduar nga Buxheti i Shtetit.
- Për vitin 2028 në shumën 24,868,792 lekë, fond i akorduar nga Buxheti i Shtetit.

1.2. Në pikën 1/b, të shtohet “Plani i shpenzimeve” në shumën 48,868,492 lekë, respektivisht:

- Për vitin 2026 në shumën 10,000,000 lekë.
- Për vitin 2027 në shumën 14,000,000 lekë.
- Për vitin 2028 në shumën 24,868,792 lekë.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës në shumën 1,720,000, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2026, për të mundësuar zbatimin e projektit të investimit me emërtim: “Rikonstruksion i kanalit ujitës, dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë”, me financim nga Buxheti i Shtetit, konkretisht si më poshtë:

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	AC127 Çështjet e Përgjithshme Ekonomike	04240	P424XXX	01	231	1,500,000	Mbikëqyerje punimesh - Rik.Kanali ujitës
				01	231	120,000	Kolaudim punimesh - Rik.Kanali ujitës
				01	231	100,000	Oponencë teknike - Rik.Kanali ujitës

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngakohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve dhe Drejtoria Juridike,.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 6873/Prot

Lezhë, më 15. 05.2026

RELACION

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
AKORDUAR NGA BUXHETI I SHTETIT DHE FONDIT TË KONTIGJENCËS**

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në zbatim të VKM nr.301, datë 24.04.2026 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga Programi “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”, dhe të shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr.3293/1, datë 13.05.2026 “Për njohje e zbatim”, relatoi si më poshtë:

- Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit është në shumën 48,868,492 lekë, që do të përdoret për financimin e punimeve të ndërtimit të projektit me emërtim: “Rikonstruksion i kanalit ujitës, dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë”, i detajuar për 3 vite 2026-2028.

- Përdorimin e fondit të kontigjencës në shumën 1,720,000 lekë, që do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve të paparshikuara në Buxhetin e vitit 2026, konkretisht për:

- 1.Mbikëqyrje punimesh për objektin “Rikonstruksion i kanalit ujitës, dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë”, në shumën 1,500,000 lekë.

- 2.Kolaudim punimesh për objektin: “Rikonstruksion i kanalit ujitës, dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë”, në shumën 120,000 lekë.

- 3.Oponencë teknike për objektin: “Rikonstruksion i kanalit ujitës, dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë” në shumën 100,000 lekë.

Kërkesa dhe relacioni shpjegues më i detajuar është paraqitur nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes e Administrimit të Pyjeve, lidhur me alokimin e fondit për të mundësuar zbatimin e këtij projekti.

Prandaj, ju propozoj miratimin e përdorimit të fondit të kontigjencës, të kërkuar si më lart.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
NJËSIA E UJITJES DHE KULLIMIT

Nr. 6437 Prot.

Lezhë, më 11/5 /2026

MIRATOHE
KRYETARI
Pjerin NDREU



Lënda: Kërkesë për alokim fondi në buxhetin e vitit 2026.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, VKM Nr. 310 datë 24.4.2026 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi Menaxhimi i infrastruktures së kullimit, për të mundësuar realizimin e projektit me emërtim “Rikonstruksion i kanalit ujitës dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, Loti II, Bashkia Lezhë”, kërkohet alokim fondi në buxhetin e vitit 2026 në programin AC127, në Funkcionin 04240 “Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, për mbulimin e shpenzimeve për mbikëqyrje punimesh, kolaudim dhe oponencë teknike në shumën 1,720,000 lekë, i cili do të përdoret si më poshtë :

Nr	Programi	Funksioni	Produkti	Kap	Art	Shuma lekë	Emërtimi
1	AC127 “Çështjet e Përgjithshme Ekonomike”	04240	P424XXX	01	231	1,500,000	Mbikëqyrje punimesh
				01	231	120,000	Kolaudim
				01	231	100,000	Oponencë teknike

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI
Paulin GJERGJI

Miratoi: A. Prendi
Konc. : R.Prendi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQESISE, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE

Nr. 6437/ prot

Lezhë më 11/5 2026

RELACION

“Rikonstruksion i kanalit ujitës dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, Loti II, Bashkia Lezhë”

Projekti “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Kotërr–Kakarriq” do të zbatohet në territorin e Bashkia Lezhë dhe përfshin Njësitë Administrative Dajç, Blinisht dhe Balldren. Ky projekt ka si objektiv rehabilitimin dhe rikonstruksionin e kanalit ujitës me gjatësi totale 2,450 ml, me qëllim përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe garantimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë për tokat bujqësore të zonës.

Kanali ekzistues paraqitet në gjendje të amortizuar për shkak të degradimit të vazhdueshëm ndër vite, mungesës së mirëmbajtjes dhe dëmtimeve të shkaktuara nga faktorë natyrorë dhe përdorimi i vazhdueshëm. Në shumë segmente janë konstatuar bllokime nga depozitimet e dherave dhe vegjetacionit, dëmtime të seksionit të kanalit, humbje të konsiderueshme të ujit si pasojë e çarjeve dhe amortizimit të strukturës, si dhe problematika që lidhen me erozionin e anëve të kanalit. Këto probleme kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e eficiencës së sistemit vaditës dhe në vështirësitë e fermerëve për të siguruar ujitjen e rregullt të tokave bujqësore.

Nëpërmjet këtij projekti synohet rikthimi në funksion të plotë i kanalit ujitës dhe përmirësimi i menaxhimit të shpërndarjes së ujit për rreth 580 ha tokë bujqësore. Nga realizimi i investimit do të përfitojnë drejtpërdrejt rreth 250 familje të zonës, të cilat mbështesin aktivitetin e tyre ekonomik kryesisht në sektorin e bujqësisë. Përmirësimi i sistemit ujitës pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimit bujqësor, shtimin e sipërfaqeve të kultivuara dhe përmirësimin e të ardhurave ekonomike të fermerëve.

Punimet e parashikuara në projekt konsistojnë në pastrimin dhe sistemimin e gjurmës ekzistuese të kanalit, realizimin e gërmimeve dhe profilimin e seksionit sipas parametrave teknikë të projektuar, betonimin dhe rehabilitimin e segmenteve të dëmtuara, si dhe ndërtimin dhe përmirësimin e veprave të artit dhe strukturave rregulluese të ujit. Gjithashtu do të realizohet stabilizimi i anëve të kanalit për mbrojtjen nga erozioni dhe do të përmirësohet aksesimi përgjatë tij për mirëmbajtjen periodike.

Realizimi i projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Kotërr–Kakarriq” përbën një investim me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale në territorin e Bashkisë Lezhë, pasi do të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën ujitëse dhe do të krijojë kushte më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunitetit të zonës.

Kërkojmë nga ana juaj alokimin e fondeve të nevojshme për mbështetjen dhe realizimin e projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Koterr–Kakarriq”. Ky financim është i domosdoshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e infrastrukturës bujqësore dhe realizimin e objektivave për vitin 2026.


DREJTORI
Paulin GJERGJI



Drejtoria e Bujqësisë

Përgjegjësi: Ing.Alda Prendi


Konceptoi: Rigers Prendi



Formati i Fish/Projektit

Emërtimi i objektit: Rikonstruksion i kanalit ujitës dega kryesore Kotërr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, Loti II, Bashkia Lezhë

01. Personat e Kontaktit Paulin Gjergji

Emri i propozuesit të projektit	Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për projektin	Bashkëlidhur projekti përkatës		
Institucioni Buxhetor/ Ministria /grupi / sektori	Bashkia Lezhë	Vendodhja e projektit	Njësia Administrative Dajç, Blinisht, Balldren

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Qëllimi i Projektit.

Qëllimi kryesor i projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Kotërr–Kakarriq” është përmirësimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore në territorin e Bashkia Lezhë, nëpërmjet rehabilitimit të kanalit ujitës me gjatësi 2,450 ml, që përfshin Njësitë Administrative Dajç, Blinisht dhe Balldren. Nga zbatimi i projektit përfitojnë drejtpërdrejt rreth 250 familje, aktiviteti ekonomik i të cilave lidhet kryesisht me bujqësinë dhe përdorimin e tokave të ujitshme. Projekti do të ndikojë pozitivisht në rritjen e të ardhurave familjare, shtimin e sipërfaqeve të kultivuara dhe përmirësimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Detyrat e projektit.

Në kuadër të realizimit të projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Kotërr–Kakarriq”, do të kryhen këto detyra kryesore:

1. Hartimi dhe organizimi i planit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin teknik dhe preventivin përkatës.
2. Pastrimi i gjurmës ekzistuese të kanalit nga dherat, vegjetacioni dhe materialet inerte që pengojnë funksionimin normal të tij.
3. Kryerja e gërmimeve dhe sistemimi i seksionit të kanalit sipas parametrave teknikë të projektuar.
4. Rikonstruksioni dhe betonimi i segmenteve të dëmtuara të kanalit për të reduktuar humbjet e ujit dhe për të rritur qëndrueshmërinë e strukturës.
5. Ndërtimi dhe rehabilitimi i veprave të artit, përfshirë:
 - o tombino,
 - o porta rregulluese,
 - o prita dhe struktura shpërndarëse të ujit.
6. Stabilizimi dhe mbrojtja e anëve të kanalit nga erozioni dhe degradimi.
7. Përmirësimi i aksesit përgjatë kanalit për mirëmbajtje dhe monitorim periodik.
8. Zbatimi i masave për sigurinë teknike dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së punimeve.
9. Kryerja e testimeve dhe verifikimeve teknike për funksionimin normal të sistemit ujitës pas përfundimit të punimeve.

10. Dorëzimi i objektit në funksion të plotë për ujitjen e rreth 580 ha tokë bujqësore në Njësitë Administrative Dajç, Blinisht dhe Balldren, duke sjellë përfitim të drejtpërdrejtë për rreth 250 familje të zones.

Rrisku

Gjatë zbatimit të projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Koterr–Kakarriq” mund të paraqiten disa rreziqe dhe sfida që mund të ndikojnë në afatet, cilësinë dhe realizimin e punimeve. Rreziqet kryesore të projektit janë:

1. Kushtet atmosferike të pafavorshme
Reshjet intensive, përmbytjet apo moti i keq mund të shkaktojnë ndërprerje të punimeve dhe vonesa në realizimin e projektit.
2. Probleme teknike gjatë zbatimit
Gjendja reale e kanalit mund të paraqesë dëmtime më të mëdha nga sa parashikohen në projekt, duke kërkuar ndërhyrje shtesë teknike.
3. Vonesa në furnizimin me materiale
Vonesat në sigurimin e materialeve të ndërtimit ose pajisjeve mund të ndikojnë në ritmin e punimeve.
4. Rreziku i erozionit dhe dëmtimeve gjatë punimeve
Punimet në terren mund të shkaktojnë rrëshqitje dheu ose dëmtime të përkohshme të strukturave ekzistuese.
5. Mungesa e mirëmbajtjes pas përfundimit të projektit
Nëse nuk realizohet mirëmbajtje periodike e kanalit, mund të rikthehen problemet e bllokimit, degradimit dhe humbjeve të ujit.
6. Ndikimet në aktivitetin bujqësor gjatë fazës së punimeve
Gjatë ndërhyrjeve mund të ketë kufizime të përkohshme në furnizimin me ujë për fermerët e zonës.
7. Rreziqe financiare
Rritja e kostove të materialeve ose punimeve shtesë të paparashikuara mund të ndikojnë në buxhetin e projektit.
8. Rreziqe për sigurinë në punë
Punimet ndërtimore paraqesin rrezik për aksidente nëse nuk respektohen standardet e sigurisë teknike dhe mbrojtjes në punë.

Për minimizimin e këtyre rreziqeve, projekti parashikon monitorim të vazhdueshëm teknik, organizim të mirë të punimeve, respektim të standardeve të sigurisë dhe bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe institucionet lokale.

Rezultatet e Projektit

Zbatimi i projektit “Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Koterr–Kakarriq” pritet të sjellë rezultate konkrete dhe afatgjata për zhvillimin e bujqësisë dhe përmirësimin e infrastrukturës ujitëse në territorin e Bashkia Lezhë.

Rezultatet kryesore të projektit janë:

1. Rikonstruksioni dhe funksionalizimi i plotë i kanalit ujitës me gjatësi 2,450 ml.
2. Përmirësimi i sistemit të shpërndarjes së ujit për ujitjen e rreth 580 ha tokë bujqësore.
3. Reduktimi i humbjeve të ujit dhe rritja e eficiencës së kanalit ujitës.
4. Përmirësimi i kushteve të ujitjes për fermerët e Njësisë Administrative Dajç, Blinisht dhe Balldren.
5. Rritja e prodhimit bujqësor dhe e sipërfaqeve të kultivuara në zonën përfituese.

6. Përmirësimi i të ardhurave ekonomike për rreth 250 familje që përfitojnë drejtpërdrejt nga projekti.
7. Ulja e kostove dhe problematikave që lidhen me mungesën ose shpërndarjen joefikase të ujit për vaditje.
8. Rritja e qëndrueshmërisë së infrastrukturës ujitëse dhe përmirësimi i mirëmbajtjes së saj në afatgjatë.
9. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve ujore dhe mbështetja e zhvillimit rural në zonën e projektit.
10. Krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve lokale në territorin e Bashkisë Lezhë.

03.Kostot e Projektit te Investimit

• Kosto e Mbikëqyrjes	1.500.000
• Kosto e Oponencës Teknike	100.000
• Kosto e Kolaudit	120.000
Kosto Totale e Projektit	1.720.000

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt / idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit	Paulin Gjergji		11.5.2026	
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)				
Koordinatori i GMS	Brikena Vuksani		11.5.2026	Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt-idesë
Komente nga Koordinatorin e GMS (nqs ka)				





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Protokolli

Kartelë shoqëruese e praktikës

I. Dërgues Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Nr. 3293/1 Prot., Datë 13.5 .2026

II. Marrësi : Bashkia Lezhë Nr. 6580 Prot., Datë 14.5 .2026
Përmbajtja : Per njohtje dhe zbatim

III. Për t/u trajtuar nga : 1. Bujqësi Datë 1 / 1 /2026
2. Financa

Shënim i Kryetarit _____

Afati kthimit të përgjigjes: 7 ditë 5 ditë 3 ditë 2 ditë Urgjent (brenda ditës)

Firmë _____

IV. Marrë në dorëzim nga Drejtori Drejtorisë përkatëse _____, Datë 1 / 1 /2026

V. Për t/u trajtuar nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës _____, Datë 1 / 1 /2026

Shënim i Drejtorit të Drejtorisë: _____

Firmë _____

VI. Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës _____, Datë 1 / 1 /2026

VII. Për t/u trajtuar nga Specialisti i Sektorit përkatës _____, Datë 1 / 1 /2026

Shënim i Përgjegjësit të Sektorit: _____

Firmë _____

VIII. Marrë në dorëzim nga Specialisti i Sektorit përkatës _____, Datë 1 / 1 /2026

Firmë _____

IX. Dorëzim i Eprorit porosites, Datë 1 / 1 /2026

X. Shënim _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 3293/1 prot.

Tiranë, më 13 05 .2026

Lënda: Për njohje dhe zbatim.

BASHKISË MAT	Mat
BASHKISË MALLAKASTËR	Mallakastër
BASHKISË VLOREË	Vlorë
BASHKISË KONISPOL	Konispol
BASHKISË DROPULL	Dropull
BASHKISË KORÇË	Korçë
BASHKISË POGRADEÇ	Pogradec
BASHKISË DEVOLL	Devoll
BASHKISË PUSTEC	Pustec
BASHKISË DIMAL	Dimal
BASHKISË POLIÇAN	Poliçan
BASHKISË ELBASAN	Elbasan

BASHKISË CËRRRIK	Cërrrik
BASHKISË LIBRAZHD	Librazhd
BASHKISË PEQIN	Peqin
BASHKISË GRAMSH	Gramsh
BASHKISË PRRENJAS	Prrenjas
BASHKISË LEZHË ✓	Lezhë
BASHKISË MIRDITË	Mirditë
BASHKISË FUSHË - ARRËZ	Fushë - Arrëz
BASHKISË VAU I DEJËS	Vau i Dejës
BASHKISË KUKËS	Kukës
BASHKISË HAS	Has

Të nderuar!


Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Vendimin nr. 301, datë 24.4.2026 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga Programi “Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”.


Përsa më sipër, lutem angazhimin tuaj, në përmbushjen në kohë të detyrimeve në zbatim të këtij vendimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ismail Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 301 , datë 24.4.2026

P Ë R

**SHPËRNDARJEN DHE DETAJIMIN E FONDIT PËR FINANCIMIN
E PROJEKTEVE TË BASHKIVE NGA PROGRAMI "MENAXHIMI
I INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT DHE UJITJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë, të pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit për vitin 2026 për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes", sipas tabelës 1. që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA

Tabela 1. Lista e projekteve

0	Institucioni përfutur	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2026	Financimi për vitin 2027	Financimi për vitin 2028
		Totali	2,200,000,000	500,000,000	750,000,000	950,000,000
1	Bashkia Konispol	Riparimi dhe mbrojtje e kanalit të Janjarit	65,300,440	14,000,000	20,000,000	31,300,440
2	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i kanaleve ujtëse të fushës së Korçës	30,651,954	6,000,000	9,000,000	15,651,954
3	Bashkia Vlorë	Skema vaditëse Llakatund VL 3	20,269,751	5,000,000	7,000,000	8,269,751
4	Bashkia Vau i Dejës	Rrjeti i dytë i kanaleve ujtëse, KU Shelqet Pistull, Bashkia Vau i Dejës	58,486,454	12,000,000	18,000,000	28,486,454
5	Bashkia Lezhë	Rikonstruksioni i kanalit ujtës, dega kryesore Koterr-Kakarriq, segmenti Gjadër-Gocaj, loti II, Bashkia Lezhë	48,868,492	10,000,000	14,000,000	24,868,492
6	Bashkia Mirditë	Rehabilitimi i rrjetit ujtës të ujëmbledhësit Malai 1, Dega Perlat (faza e 4)	64,000,784	14,000,000	20,000,000	30,000,784
7	Bashkia Has	Rehabilitimi i kanalit ushqyes të ujëmbledhësit Llakaj dhe rehabilitimi i skemës ujtëse	116,322,323	24,000,000	35,000,000	57,322,323
8	Bashkia Cërrik	Rehabilitimi i kanaleve vaditëse nësitë administrative Shalës dhe Klos Përmirësimi i skemës vaditëse, nësitë administrative Gostimë, Mollas dhe Cërrik	77,102,257 135,141,772	16,000,000 37,100,000	50,655,710 41,000,000	10,446,547 57,041,772
9	Bashkia Devoll	Rehabilitimi i kanalit ujtës Qytezë-Menkulus, Devoll	38,020,643	8,000,000	12,000,000	18,020,643
10	Bashkia Peqin	Ndërtimi i veprës së marrjes dhe zgjatimi i kanalit të Darsisë, Njësia Administrative Gloçaj	254,942,760	52,000,000	76,000,000	126,942,760
11	Bashkia Dimal	Rehabilitimi i kanaleve vaditëse të rezervuarit Gorican dhe Poshtë	93,953,165	20,000,000	28,000,000	45,953,165
12	Bashkia Polçan	Rehabilitimi i sistemit ujtës me burime ujëmbledhësin Prokuc, Bashkia Polçan	39,808,753	8,000,000	12,000,000	19,808,753
13	Bashkia Pogradec	Rikonstruksion kanalit ujtës rezervuari Qafëthanë-Boqezë	8,772,145	8,772,145		
14	Bashkia Mat	Rehabilitimi i kanalit ujtës të ushqyesit të ujëmbledhësit të Bazil nr. 2 dhe degëzimi Karicë	114,983,598	23,000,000	35,000,000	56,983,598
15	Bashkia Mallakastër					

		Rehabilitimi i rrjetit ujites të fshes së Hekallit	121,333,658	24,500,000	36,500,000	60,333,658
16	Bashkia Elbasan	Rehabilitimi i pellgut ujmbledhës përroit të Zaranikës dhe rikonstruksioni i digës dhe i shtrattit të përroit të Zaranikës, Elbasan (faza II) Rikonstruksioni i shtrattit Zaranikë km 0 + 440 - km 3+100	200,989,536	52,700,000	116,091,358	32,198,198
17	Bashkia Gramsh	Rehabilitimi i kanalit vaditës Grabovë - liqeni i Dushkut	142,409,861	41,727,835	43,000,000	57,682,006
18	Bashkia Librazhd	Ripartimi i digave ekzistuese të liqeneve akullnajore nr. 1 dhe nr. 2 Kusar dhe rikonstruksioni i kanalit të Malit Kusar - Fushë Studen-Letem (L=11.8 km për 900 ha)	175,020,156	35,200,000	52,600,000	87,220,156
19	Bashkia Përrenjas	Rikonstruksioni i kanalit Lingajces, faza IV	83,164,795	17,000,000	25,000,000	41,164,795
20	Bashkia Pustec	Ndërtim i kanaleve për sistemin e vaditjes dhe ujtes për zonën Pustec-Lajthizë dhe rikonstruksioni i digës së rezervuarit Lajthizë 1, 2, 3	86,701,500	20,000,000	27,000,000	39,701,500
21	Bashkia Fushë-Arrëz	Kanali vaditës Fushë-Arrëz dhe Nushal	84,120,783	17,000,000	26,000,000	41,120,783
22	Bashkia Kukës Bashkia Kukës	Rehabilitimi i kanalit ujtes Shliqën	20,152,932	10,000,000	10,152,932	
23	Bashkia Dropull	Rehabilitimi i sistemit ushqyes nga rezervuari i L.ikomilit në rezervuarin e Vrisesas	119,481,468	24,000,000	36,000,000	59,481,468

NR.PROT. 2500/A
DATE 27.4 2026

MINISTRISË SË BUIQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRISË SË FINANCAVE
TË GJITHA BASHKIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsnida RAMA

